



Prishtinë: 27.11.2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1208\_2019

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1934\_05\_19**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **08.11.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 27.11.2019, nxori këtë:

### V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit S.K. (parashtruesja V.D.) nga Prishtina me shifër të konsumatorit 012774 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1934\_05\_19** i datës 03.05.2019.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18.11.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori V.D. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se ZRRE nuk ka marrë për bazë ankesën e konsumatorit për lirim nga obligimet në vlerë prej 247.79€. Konsumatori në ankesë ka theksuar se gjatë vitit 2014 nuk ka pasur ngrohje qendrore të ofruar nga NQ "Termokos" dhe se pas 2015 të gjitha obligimet i kemi përfunduar pasi ka pasur ngrohje. Konsumatori në ankesë ka theksuar se nuk kanë pranuar nga NQ "Termokos" përgjigje në ankesat e tyre dhe se në njërin përgjigje të ngrohtores nuk janë shqyrtuar pretendimet ankimore për mos ngrohje të vitit 2014. Konsumatori në ankesë ka theksuar se gjatë periudhës 2014 sa nuk ka pasur ngrohje janë ngrohur me energji elektrike dhe si provë janë edhe shpenzimet e energjisë elektrike të periudhës 2014 dhe 2015.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se ka theksuar se ZRRE nuk ka marrë për bazë ankesën e konsumatorit për lirim nga obligimet në vlerë prej 247.79€, Bordi i ZRRE thekson se kjo nuk qëndron pasi që ashtu edhe siç shihet edhe në vendimin e organit të shkallës së parë vërehet qartë se vendimi është i bazuar në të gjitha shkresat e lëndës të parashtruar nga vet konsumatori dhe nga NQ "Termokos". Bordi i ZRRE thekson se organi i shkallës së parë ka bërë analizimin e ankesës suaj lidhur



me kundërshtimin e faturave të ngrohjes së energjisë termike të vitit 2014, e këtë e dëshmon edhe fakti se në vendimin e organi të shkallës së parë theksohet se nga faturat e energjisë termike dhe kartela e konsumatorit të shifrës 012774 konstatohet se NQ "Termokos" për muajin 01/2014 dhe 12/2014 ka bërë faturim të plotë të energjisë termike (pa zbritje) për konsumatorin, ndërsa për muajt 02/2014 dhe 03/2014, ka bërë zbritje të faturimit të energjisë termike në 10 ditë respektivisht 20 ditë, e që kjo zbritje zakonisht bëhet për shkak të cilësisë së dobët të ngrohjes dhe për ditët pa ngrohje.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se nga NQ "Termokos" nuk ka marrë përgjigje në ankesat e tyre dhe se në një të përgjigje të ngrohtores nuk janë shqyrtuar pretendimet ankimore për mos ngrohje të vitit 2014, Bordi i ZRRE-së thekson se edhe organi i shkallës së parë ka theksuar se në përgjigjen e NQ "Termokos" të datës 15.02.2018 nuk është bërë një konstatim detaj se e ka pasur ngrohje në periudhën e kontestuar, porse ipet vlerësim për furnizimin aktual me ngrohje. Bordi i ZRRE thekson se edhe organi i shkallës së parë ka analizuar edhe faturat e energjisë elektrike të periudhës 2014 dhe 2015, nga ku edhe ka konstatuar se konsumatori ka konsum të energjisë elektrike mbi 50% më të madh në vitin 2014 krahasuar me vitet vijuese 2015 – 2018, pra edhe ky fakt është marrë parasysh gjatë marrjes së vendimit.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se gjatë periudhës 2014 sa nuk ka pasur ngrohje janë ngrohur me energji elektrike dhe si provë janë edhe shpenzimet e energjisë elektrike të periudhës 2014 dhe 2015, Bordi i ZRRE ka theksuar se bazuar në dëshmitë e parashtraur nga konsumatori dhe NQ "Termokos" është konstatuar se NQ "Termokos" ka bërë pjesërisht zbritjet e lartë-përshkuara në faturim për muajt e kontestuar. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së thekson se nuk mundet me saktësi të konstatohet cilësia e furnizimit me ngrohje në periudhën e lartpërmendur (kontestuar), dhe kjo është evidentuar edhe në vendimin e organit të shkallës së parë, si dhe është fakt përgjithësisht i njohur se para funksionalizimit të koogjenerimit, cilësia e ngrohjes ka qenë më e dobët. Andaj Bordi i ZRRE-së thekson se organi i shkallës së parë me të drejtë ka vendosur që ankesa pjesërisht duhet të aprovohet, duke bërë zbritjet përkatëse edhe për muajt janar dhe dhjetor 2014, respektivisht është vendosur një mesatare e ditëve të zbritura prej 15 ditëve, që reflekton mesataren e ditëve të zbritura për muajt shkurt dhe mars 2014

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme dhe duke kërkuar kompensim dëmi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.11.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.



**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit S. K. (parashtruesja V.D.)
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së